



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-Kuvendi i Komunës-

01 - Nr. 16-3002/12.
Kaçanik; 29.02.2012.

Në bazë të nenit 17, 24 dhe 40.2(g) të Ligjit nr.03/L-040 - Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 2, 8 dhe 10 të Ligjit nr.03/L-049 – Për Financat e Pushtetit Lokal, të nenit 34.5 lidhur me nenin 61. të Statutit të Komunës së Kaçanikut, me Rekomandim të KPF-a të datës: 23.02.2012 për Aprovimin e Propozim-Vendimit të Kryetarit të komunës, 01Nr. 16-3002/12, prej datës 20.02.2012, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 29.02.2012, mori këtë:

V E N D I M
PËR LIRIMIN E BIZNESEVE NGA TAKSA KOMUNALE - NGARKESA VJETORE
PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË TYRE AFARISTE

1. Me këtë Vendim iu lejohej lirimi (heqja) e plotë e taksës komunale - ngarkesës vjetore të gjitha bizneseve, për ushtrimin e veprimtarisë së tyre afariste gjatë tri (03) viteve vijuese 2012-2014.

Ndërsa, pronarëve të bizneseve nga Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve dhe Veteranëve të Luftës së UÇK-së, iu bëhet lirimi nga kjo taksë komunale për pesë (05) vitet vijuese 2012-2016.

2. Përfutjes të këtij lirimi nga kjo lloj e taksës komunale vjetore, do të jenë të gjitha ato biznese të cilët nuk kanë obligime apo gjatë vitit 2012 do t'i kryejnë të gjitha obligimet që kanë të bëjnë lidhur me biznesin.

3 . Ky Vendim hyn në fuqi me aprovimin në Kuvend të Komunës dhe do të vlejë sipas pikës 1. të këtij vendimi, për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.

4. Me aprovimin e këtij Vendimi shfuqizohet Pjesa 10 – Ngarkesat vjetore komunale për ushtrimin e veprimtarive afariste, përkatësisht neni 19, 20 dhe 21. e Rregullorës nr.01-05-4236/10. – Për Pagesën e Tarifave dhe Ngarkesave Administrative dhe Shërbimeve të Tjera komunale.

5. Për zbatimin e këtij Vendimi, obligohet Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.

Me këtë vendim njoftohen :

1. Kryetari i komunës,
2. Drejtoria e Ekonomisë, Financaave dhe Zhvillimit dhe
3. Arkivi.

Kryesuesi i kuvendit,
z. Xhelal Gashi
